



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:164866

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05587873

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.C., nga fshati ... Komuna Gjakovë, për shkak të veprave penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzave të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë PP/II.nr.984/23 të datës 31.07.2023 dhe PP/II.nr.329/23 të datës 18.09.2023, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **17.04.2024**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të dëmtuarit SH.K., dhe të akuzuarit E.C., me datën 18.04.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.C.**, nga fsh. ... K Gjakovë, i lindur me dt. ..., i biri i dhe i nënës .. e gjinisë H., ka të kryer III klasë të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, atë i 3 fëmijëve, egjiptian, shtetas i R. Kosovës, ID ...

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

I.- Me dt.04.07.2023, rreth orës 10:30 min, në Rr.”...” në Gjakovë, përkatësisht në garazhin e objektit të hotelit “...”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër i merr pasurinë e luajtshme këtu të dëmtuarës A.D., në atë mënyrë që parapakisht e demtuara kishe lene bicikleten ne garazhin e objektit ku punon- hotel „Pashtrik“ i pandehuri pasi që parapakisht sigurohet që nuk verehet nga askush merr bicikleten e te demtuares dhe largohet ne drejtim të panjohur te cilen biciklete me pas e shet ne hekurishte te B.K., ne cmim prej 10 eurove, me ç ‘rast të dëmtuarës i shkakton dëm material.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par .1 të KPRK-së.

II.- Me datë 10.01.2023 rreth orës 15:30 në Rr.”...” në Gjakovë, saktësisht në hyrje të banesës së të dëmtuarit, i pandehuri me qëllim që vetit apo tjetrit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka marrë sendin e luajtshëm pronë e të dëmtuarit SH.K., në atë mënyrë që i pandehuri duke e shfrytëzuar momentin e vulltshëm gjersa nuk po verehej nga askush nga vend parkimi i destinuar për biçikleta e merr biçikletën ngjyrë të zezë, e markës Gjermane, pronë e të dëmtuarit dhe largohet nga aty, mirëpo pas një pune operative të policisë biçikleta sekuestrohet dhe e njëjta i kthehet të dëmtuarit.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitës së neneve 2, 3 paragraf 1, nenit 4, 6, 7, 17, nenit 38, nenit 39 paragraf 1 nën paragraf 1.1 dhe 1.2, nenit 40 paragraf 1, nën paragraf 1.2 nenit 42, 43, nenit, 69, 70, 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3, nenit 248 paragraf 1, nenit 321 paragraf 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale ,të akuzuarin e :

G J Y K O N

- Për veprën penale të përshkruar në pikën e I-rë të dispozitivit Vjedhje nga neni 313par.1 të KPRK-së , shqiptohet dënim me gjobë në shumë **prej njëqind (100) euro**, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve**.

-Për veprën penale të përshkruar në pikën e dytë të dispozitivit Vjedhje nga neni 313par.1 të KPRK-së , shqiptohet dënim me gjobë në shumë **prej njëqind (100) euro**, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve**.

Gjykata konform dispozitave të nenit 76 paragraf 2 nën paragraf 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së:

Të akuzuarit të parë i shqipton **DËNIM UNIK ME BURGIM**, në kohëzgjatje **prej njëqind (100) ditësh**, si dhe i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqind) euro**, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, atëherë gjykata mund të iu zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 ditësh, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës, do të i llogaritet me një ditë burgim.

Të dëmtuarit A.D., dhe SH.K., , që të dy nga Gjakova, për të realizuar kërkesën e saj pasurore juridike për kompensim dëmi, udhëzohet në kontest civil,

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.984/23 të datës 31.07.2023 dhe PP/II.nr.329/23 të datës 18.09.2023 , ka akuzuar të akuzuarin E.C., nga Gjakova ,për shkak të veprave penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së

Gjykata konstaton se me aktvendimin 2023:164866 të dt. 18.01.2024, ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qenë se i akuzuari E.C., , nuk ka marr pjesë ne seancat e caktuar për te cilin është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim nga st. Policor në Gjakovë , të cilët sipas njoftimit me nr. ref. 04/1-08-Gj-S-09/24 të dt. 17.01.2024, jemi njoftuar se i njëjti është kërkuar ne adresën e dhënë por i njëjti nuk është gjetur , dhe nga vëllai i tij L... jemi njoftuar se E.. ka tri vite qe nuk banon ne familjen e tij , banon ne vend te ndryshme ,andaj për te njëjtin ka lëshuar edhe urdhër arrest.

Nga zy. policor H.GJ., gjykata është njoftuar se i pandehuri E.C., është dërguar ne vuajtje te dënimit ne Qendrën e te Burgosurve ne Pejë , ku i njëjti është shoqëruar nga njësiti për shoqërimin e te burgosurve me datën 17.04.2024 , i njëjti do te procedohet dhe gjykata benë tërheqja e urdhër arrestit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 17.04.2024 , ka vendosur sipas propozimit të ë akuzuarit për bashkimin e lëndëve penale dhe atë: me P.nr. 2023:164866 si dhe P.nr.2023:199392 dhe zhvillimin e përbashkët te procedurës penale për këto 2 lëndë penale dhe pajtimit të prokurorit të

shtetit ashtu që ,ka bërë bashkimin e këtyre 2 lëndëve penale dhe shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me **numër unik P.nr. 2023:164866**.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.04.2024 pas leximit të aktakuzave me numër aktakuzën PP/II.nr.984/23 të datës 31.07.2023 dhe PP/II.nr.329/23 të datës 18.09.2023 , deklaroi se me që i pandehuri në këtë shqyrtim fillestare vullnetarisht e ka pranuar veprat penale pasi që është njoftuar me pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë , e shtuar këtu se pranimi i fajësisë është në përputhje me kualifikimin ligjor si dhe me provat që gjenden në shkresa të lëndës ,i rekomandojë gjykatës që përmes aktvendimit të aprovojë deklarin e të pandehurit për fajësinë. Lidhur me vendimin për dënim i propozon gjymtës qe si rrethana lehtësuese te merret pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës si dhe pendimi për veprat e kryera, ndërsa si rrethanë renduese te vlerësojë faktin se i njëjti është recidivist i natës se njëjtë te veprave penale .

I akuzuari E.C., , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, thekson se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaron: se ndihem fajtor për veprat penale me te cilën pandehem sipas aktakuzave, duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë , shtoj se me pranimin e fajësisë ne çdo fazë te procedurës jam penduar për veprat e kryer për shkak te gjendjes se dobët ekonomike ,kërkojë falje nga te dëmtuarit për veprimet e mija, edhe pse e di qe te njëjtëve biçikletat ne fjalë i janë kthyer ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet me qe tani jam ne vuajtje te dënimit me burgim , gjë e cila ka ndikuar qe te risocializohem, gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se një veprim i tillë nuk do te përsëritet ,kthimi i gjësendeve te dëmtuarve , kërkim falje publike në gjykatë , gjendjen e dobët ekonomike, të me shqiptojë një dënim me te butë .

I dëmtuari SH.K., deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qe biçikleta me është kthyer .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuari pasi qe ky pranim i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimi te tillë , pranim është bërë pas sqarimit të mjaftueshëm nga ana e gjykatës, po ashtu faktin se pranim i fajësisë mbështet në faktet e çështjes ,respektivisht provave materiale dhe personale qe përmbajnë aktakuzat.

2 .Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit E.C., , është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas sqarimit të mjaftueshëm edhe nga ana e gjykatës, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike: se i akuzuari E.C., , me dashje ka kryer veprat penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së , në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në diapozitivat n e këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Sipas nenit 313 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vjedhjes e kryen: *“Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej (50) euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre(3) vjet.*

5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin E.C., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet sipas aktakuzave të lartcekura, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta i gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69, 70, 71 par.1 nën. par.1.1 dhe 1.3 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Sa i përket rrethanave rënduese për të akuzuarin gjykata në rastin konkret pati parasysh faktin se nga Evidenca penale PDP për të akuzuarin i njëjti evidentohet me këto lëndë penale PM.nr.47/22 - neni 313/1 - Masë edukative - Mbikëqyrje e shtuar nga ana e prindit në kohëzgjatje për (një) 1 vit. Urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. -i PF.30.11.2022.:P.nr.59/22 - neni 313/1 - Dënim me kusht 180 ditë për 1 vit dhe gjobë 200 euro -i PF.29.12.2022.; P.nr.2023:043351 - neni 313/2 - Dënim me burg 70 ditë - i Pf.12.07.2023;P.nr.2023:153752 - neni 313/1 - Dënim me burg 60 ditë dhe gjobë 100 euro i Pf.26.12.2013, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është i moshës relativisht të re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale pasi veprat penale i ka kryer për shkak të gjendjes tejet të dobët ekonomike, jeton në kushte ekstreme të dobëta në barakë në bashkësi familjare prej 7 anëtarësh ku asnjëri nuk është i punësuar. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në çdo fazë të procedurës penale për veprat penale për të cilat ngarkohet, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur, kërkim falja publike nga të dëmtuarit, kthimi i biçikletave të dëmtuarit gjë e cila vërtetohet edhe nga deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi pasi i është kthyer biçikleta, andaj gjykata duke u bazuar në të gjitha këto rrethana ka ardhur në përfundim që ti zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 70 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënimin unik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këto dënime do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarit A.D., dhe SH.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, të kërkesës pasurore juridike.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par. 4 të KPPRK-së, pasi që gjykata ka konstatuar se i akuzuari E.C., është i gjendjes tejte të rënd ekonomike duke marrë parasysh se i njëjti jeton në bashkësi familjare prej 7 anëtarësh , ku asnjëri nuk është i punësuar, konsiderojmë se pagesa e këtyre shpenzimeve do të rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal
P.nr.2023:164866 më datë 18.04.2024
P.nr.2023:199392 më datë 18.04.2024

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.